



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 3

Tiranë – E enjte, 9 janar 2025

## PËRMBAJTJA

|                                                           | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 12, datë 9.1.2025 | Për transferimin të Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e nënprojekteve “Copëzat”, “Hospitality” dhe “Godina e re e Bibliotekës Kombëtare”, pjesë e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore” ..... 355                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 13, datë 9.1.2025 | Për transferimin të Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, nr. 310, nr. 324/2, nr. 324/4, zona kadastrale 3852, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Shijak, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe inovacionit të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’” ..... 359 |





**VENDIM**  
**Nr. 12, datë 9.1.2025**

**PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA  
E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË  
PRONAVE SHTETËRORE, NË  
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA  
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, PËR  
REALIZIMIN E NËNPROJEKTEVE  
“COPËZAT”, “HOSPITALITY” DHE  
“GODINA E RE E BIBLIOTEKËS  
KOMBËTARE”, PJESË E PROJEKTIT TË  
INVESTIMIT “PËR ZHVILLIMIN DHE  
MENAXHIMIN E PRONAVE  
SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe në zbatim të shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Transferimin, në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore, sipas shtojcës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për realizimin e nënprojekteve të investimit “Copëzat”, “Hospitality” dhe “Godina e re e Bibliotekës Kombëtare”, pjesë e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”.

2. Autorizimin e shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj për të vepruar si zhvillues i pronave, me funksion vetëm publik, në emër dhe për llogari të pronarit shtet për pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare apo entiteti i krijuar prej saj zhvillon pronat e përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij

vendimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, të cilat kanë si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

4. Autorizohen Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, apo autoritetet e autorizuar prej tyre, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetit në pronësi apo përgjegjësi administrimi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore, që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/autorizimit për zhvillim, në të cilin përcaktohen edhe kushtet e nevojat për dorëzimin e pronës, si dhe sigurimin e ambienteve të përkohshme për vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike, që përdorin/administrojnë këto prona, në rastet kur institucionet për nevoja të zhvillimit të projektit të investimit janë të detyruara të lirojnë këto prona.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për kryerjen e procedurave përkatëse, për secilin nga nënprojektet, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, *leasing*, shitje, përdorim, si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, për zhvillimin e pronave të shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, nëpërmjet instrumentit ligjor të enfitëozës dhe/ose sipërmarrjes.

6. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negocimin me subjekte private dhe publike, me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projekteve të investimit, si dhe pronat për të cilat ka marrë autorizim për zhvillim, bazuar në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave dhe në aktet nënligjore në zbatim të tyre.

7. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit, apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit, si dhe të sigurojë regjistrimin,



në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronës së re shtetërore, që do të krijohet në kuadër të projekteve të investimit.

8. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, vetëm pasi ka siguruar vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike, që përdorin/administrojnë këto prona, në ambiente të tjera deri në marrjen në dorëzim të ambienteve të reja të ndërtuara, si dhe në zbatim të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, ngarkohet Korporata të kryejë procesin e konsolidimit të pronave të shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, në rast se konstatohet mospërputhje midis gjendjes faktike dhe ligjore të pronës.

9. Në listat e pronave, që i bashkëlidhen vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 4.7.2018, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pjesëve takuese të pronës, me emërtimin “Garda e Republikës, garnizon”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8270, me numër pasurie 4/134, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 815, datë 29.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës”, të ndryshuar, nr. 1058 datë 16.7.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë

e Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar, nr. 515 datë 18.7.2003, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, hiqen pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Pika 5 e vendimit nr. 142, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe objekti, brenda territorit të pronës nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Mbrojtjes”, me vendndodhje bulevardi “Zhanë D’Ark”, Tiranë, disa ndryshime në vendimin nr. 572, datë 3.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve të Brendshme, të objektit nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Mbrojtjes”, për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, dhe shfuqizimin e vendimit nr. 786, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave”, dhe në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 572, datë 3.9.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve të Brendshme, të objektit nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Mbrojtjes”, për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike”, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama



SHTOJCA NR. 1  
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

| Nr. | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e pasurisë (m <sup>2</sup> ) | Nga sip.                 |                            | Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-----|-----------------|----------------|-----------------------------------|--------------------------|----------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     |                 |                |                                   | Truall (m <sup>2</sup> ) | Ndërtesë (m <sup>2</sup> ) |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 1   | 8150            | 1/529          | 379                               | -                        | -                          | Shtet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 2   | 8150            | 1/451          | 608                               | 608                      | 251                        | Ministria e Mbrojtjes<br>Vendimi nr. 515, datë 18.7.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| 3   | 8150            | 1/583          | 2062.14                           | -                        | -                          | Shtet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| 4   | 8270            | 4/869          | 9258                              | 9258                     | 1843                       | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit<br>Vendimi nr. 406, datë 4.7.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pjesëve takuese të pronës me emërtimin “Garda e Republikës, garnizon”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8270, me numër pasurie 4/134, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 815, datë 29.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës”, i ndryshuar” |
| 5   | 8190            | 8/552          | 5219                              | 5219                     | 750.81                     | Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare<br>Vendimi nr. 1058 datë 16.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |

SHTOJCA NR. 2  
PRONAT ME FUNKSION PUBLIK PËR TË CILAT KORPORATA VEPRON SI ZHVILLUES

| Nr. | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e pasurisë (m <sup>2</sup> ) | Nga sip.                 |                            | Institucioni me përgjegjësi administrimi/pronësi                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-----|-----------------|----------------|-----------------------------------|--------------------------|----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     |                 |                |                                   | Truall (m <sup>2</sup> ) | Ndërtesë (m <sup>2</sup> ) |                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| 1   | 8602            | 43/293/ND      | -                                 | -                        | 332.48                     | Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare<br>Vendimi nr. 1058, datë 16.7.2008, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, i ndryshuar. |
| 2   | 8602            | 43/292/ND      | -                                 | -                        | 186.18                     | Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare<br>Vendimi nr. 1058, datë 16.7.2008, i                                                                                                                                                                                                                                |



|   |      |           |      |      |         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---|------|-----------|------|------|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|   |      |           |      |      |         | Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| 3 | 8602 | 43/291/ND | -    | -    | 1126    | Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare Vendimi nr. 1058 datë 16.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| 4 | 3072 | 5         | 8100 | 8100 | 1035.17 | Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare Vendimi nr. 1058, datë 16.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| 5 | 8270 | 4/866     | 3876 | 3876 |         | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit<br>Vendimi nr. 406, datë 4.7.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pjesëve takuese të pronës me emërtimin ‘Garda e Republikës, garnizon’, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, me numër pasurie 4/134, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 815, datë 29.11.2007, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës’, i ndryshuar” |

**SHTOJCA NR. 3**  
**INSTITUCIONET PUBLIKE, TË CILAT LIDHIN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME**  
**KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE**

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;  
 Shkolla Shqiptare e Administratës Publike;  
 Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.



## VENDIM

Nr. 13, datë 9.1.2025

**PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E  
INVESTIMEVE SHQIPTARE TË  
PRONAVE SHTETËRORE NR. 336, NR.  
338/1, NR. 318, NR. 310, NR. 324/2, NR.  
324/4, ZONA KADASTRALE 3852, ME  
VENDNDODHJE NË XHAFZOTAJ,  
BASHKIA SHIJAK, DHE PËR DISA  
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 185,  
DATË 27.3.2024, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NGA  
RADIOTELEVIZIONI SHQIPTAR NË  
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË  
MINISTRISË SË EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVACIONIT TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME  
SHTETËRORE NR. 336, NR. 338/1,  
NR. 318, NË ZONËN KADASTRALE 3852,  
XHAFZOTAJ, BASHKIA DURRËS, DHE  
MIRATIMIN E HAPJES SË PARKUT  
TEKNOLOGJIK DHE SHKENCOR  
‘DURANA TECH PARK’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitheozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, sipas dokumentacionit/kartelave të pronësisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Shijak, sipas dokumentacionit /kartelave të pronësisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare në rolin e zhvilluesit të parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park” apo entiteti i krijuar prej saj do të përdorë pasuritë e paluajtshme shtetërore me nr. 338/1, nr. 318, nr. 310, nr. 324/2, nr. 324/4, zona kadastrale 3852, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Shijak, në funksion të parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”, të hapur me vendimin nr. 185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’”.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, të kryejë veprimet me institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit, apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”, si dhe të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për konsolidimin e pronës.

5. Në funksion të realizimit të parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”, të përcaktuar në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Në vendimin nr. 185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Për miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’”.

b) Pika 1 shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Radiotelevizioni Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e



Investimeve Shqiptare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1  
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

| Nr. | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e pasurisë (m <sup>2</sup> ) | Nga sip.                 |                            | Institucioni me përgjegjësi administrimi/ pronësi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|-----|-----------------|----------------|-----------------------------------|--------------------------|----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|     |                 |                |                                   | Truall (m <sup>2</sup> ) | Ndërtesë (m <sup>2</sup> ) |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 1   | 3852            | 336            | 140400                            | -                        | -                          | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit<br>VKM nr. 185, datë 27.3.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’” |
| 2   | 3852            | 338/1          | 40600                             | 40600                    |                            | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit<br>VKM nr. 185, datë 27.3.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’” |
| 3   | 3852            | 318            | 81200                             | -                        | -                          | Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit<br>VKM nr. 185, datë 27.3.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor ‘Durana Tech Park’” |



SHTOJCA NR. 2  
PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

| Nr. | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e pasurisë (m <sup>2</sup> ) | Nga sip.                 |                            | Institucioni me përgjegjësi administrimi/pronësi |
|-----|-----------------|----------------|-----------------------------------|--------------------------|----------------------------|--------------------------------------------------|
|     |                 |                |                                   | Truall (m <sup>2</sup> ) | Ndërtesë (m <sup>2</sup> ) |                                                  |
| 1   | 3852            | 310            | 108100                            | 108100                   |                            | Radiotelevizioni Publik Shqiptar                 |
| 2   | 3852            | 324/2          | 5200                              | 5200                     | 3000                       | Radiotelevizioni Publik Shqiptar                 |
| 3   | 3852            | 324/4          | 139 565.5                         | -                        | -                          | Radiotelevizioni Publik Shqiptar                 |





Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 48 lekë